



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2022

Shtojca 10

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Date 16/02/2022

Drejtuar: Operatorit Ekonomik "LINDA-80" SHPK, me adrese Rruga Kryesore Lezhe – Tirane km 3, Lezhe.

Procedura e prokurimit/lotit: **E Hapur/ Mallra**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-17696-01-24-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **"Blerjen Naftë për nevoja të Bashkisë Lezhe"**.

Kohëzgjatja e kontratës: **12 Muaj nga data e nënshkrimit të Marreveshjes Kuader.**

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik "EUROPETROL DURRES ALBANIA" SH.A, me Nuis K24010212N, me oferte ekonomike **33,637,126.38** (tridhjetë e tre milion gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e gjashtë *pike* tridhjetë e tetë) Lek pa Tvsh dhe me norme fitimi në vlerë absolute prej **11.40** (njëmbëdhjetë pike dyzet) Lek pa TVSH,
2. Operatori Ekonomik "LINDA-80" SHPK, me Nuis K37513530U, me oferte ekonomike **35,792,954.3** (tridhjetë e pesë milion e shtatëqind e nentëdhjetë e dy mijë e nentëqind e pesëdhjetë e katër *pike* tre) Lek pa Tvsh dhe me norme fitimi në vlerë absolute prej **19.99** (nëntëmbëdhjetë pike nentëdhjetë e nente) Lek pa TVSH,

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I-Operatori Ekonomik "EUROPETROL DURRES ALBANIA" SH.A, me Nuis K24010212N,

Se pari, nuk plotëson kriterin 1, në lidhje me Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit dhe 2.1 a), të kushteve të veçanta të kualifikimit në të cilin përcaktohet se ky kriter

plotesohet sipas përcaktimeve të vendosura në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe te vecanta te kualifikimit (Shtojcat).

Kvo, veren se ne shtojcen 7 parashikohet si me poshte:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
 - b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
 - c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
 - ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
 - d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 - f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
 - gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
 - h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
 - i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Gjithashtu KVO, veren se bazuar ne piken 1 dhe 2(c) te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, ku parshikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla,

2. formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinimin, si më poshtë vijon:

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese

brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

, per te permbushur këto kritere duhet të paraqitet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit të operatoreve ekonomike në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori Ekonomike nuk ka plotësuar të dhenat për personin/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në kreun A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, në seksionin në lidhje me informacionin dhe deklarinimin në zbatim të pikës 2(c) të nenit 26, të VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën duhet të deklarohet si më poshtë:

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

Sa me sipër duke qenë se Operatori Ekonomike, nuk ka deklaruar në shtojcën 12 emrat e personit/ave në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, ky kriter konsiderohet i papërbushur.

Se dyti, nuk plotëson kriterin 2.3.1 të kushteve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate;
ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Theksojmë se për të përmbushur pikën 2.3.1, në lidhje me dëshmitë për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate;
ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të

legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Nga verifikimi në SPE, rezulton se OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që deshmon për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Se treti, nuk ploteson kriterin 2.3.3 të kushteve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: Operatori/et ekonomike ofertues duhet të kenë të punësuar të paktën 5 (pese) punonjës për periudhën Nentor 2021 – Dhjetor 2021, të vërtetuar me:

-Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Nentor 2021 – Dhjetor 2021.

-Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Nentor 2021 – Dhjetor 2021

Shenim: Kjo kërkesë përbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit.

KVO verën se bazuar në pikën 1 të nenit 26, të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për të përbushur këto kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetedeklarojnë në formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se, të dhenat e stafit e punësuar që disponon sipas përcaktimeve të mesipërme.*

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori Ekonomike, nuk ka vetedeklaruar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, të dhenat në lidhje me stafin e punësuar që disponon.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur në nenin 76, pikë 3/a dhe në nenin 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar

nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “EUROPETROL DURRES ALBANIA” SH.A, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “EUROPETROL DURRES ALBANIA” SH.A, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “LINDA-80” SHPK, me adresë Rruga Kryesore Lezhe – Tirane km 3, Lezhe, se oferta e paraqitur prej **35,792,954.3** (tridhjetë e pesë milion e shtatëqind e nentëdhjetë e dy mijë e nentëqind e pesëdhjetë e katër *pikë* tre) Lek pa Tvsh dhe me norme fitimi e shprehur në vlerë absolute prej **19.99** (nëntëdhjetë pike nentëdhjetë e nente) Lek pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI

Pjerin NDREU

Personi Pergjegjes
Altin Lleshi
